



UNIVERSITETI I EVROPËS JUGLINDORE
УНИВЕРЗИТЕТ НА ЈУГОИСТОЧНА ЕВРОПА
SOUTH EAST EUROPEAN UNIVERSITY

*“MAQEDONIA NË MARRËDHËNIET NDËRKOMBËTARE
ANALIZA E POLITIKËS SË JASHTME PAS PAVARËSIMIT”*

MENTORI:

Prof.Dr.Abdulla Azizi

KANDIDATI:

Yllka Kaba Bekteshi

SHKURT 2021, TETOVË

PËRMBAJTJA

LËNDA E HULUMTIMIT.....	5
QËLLIMI I HULUMTIMIT.....	5
ARSYESHMËRIA E PUNIMIT TË TEZËS	5
HIPOTEZAT.....	5
HIPOTEZA KRYESORE.....	6
HIPOTEZAT NDIHMËSE.....	6
METODOLOGJIA E HULUMTIMIT.....	6
METODA KRAHASUESE.....	6
METODA E ANALIZËS.....	7
METODA EMPIRIKE -INTERVISTË.....	7
STRUKTURIMI I PUNIMIT.....	7
HYRJE.....	9
ZHVILLIMI HISTORIK I POLITIKAVE TË JASHTME TË MAQEDONISË PAS PAVARËSIMIT.....	11
ORGANIZATA E KOMBEVE TË BASHKUARA (OKB).....	12
ANËTRËSIMI NË KËSHILLIN E EUROPËS.....	15
STRUKTURA ORGANIZATIVE E KËSHILLIT TË EVROPËS.....	16
KONFERENCA E OJQ-VE	17
MAQEDONIA NË KËSHILLIN E EVROPËS	17
PARTICIPIMI NË OSBE.....	18
ANËTARËSIMI I MAQEDONISË NË OSBE- ORGANIZATA PËR SIGURI DHE STABILITET.....	18
PARTICIPIMI I MAQEDONISË NË NISMAT RAJONALE.....	19
RAPORTI MAQEDONI SHQIPËRI	20
RAPORTI KOSOVË – MAQEDONI.....	22
BASHKËPUNIMI EKONOMIK.....	23

KONFLIKTI I GJUHËS DHE TË DREJTËS TRASHËGIMORE HISTORIKE BULLGARI- MAQEDONI.....	23
KONFLIKTI MBI IDENTITETIN MAQEDONAS NGA SHTETI GREK.....	26
PASQYRË E FUNKSIONIMIT TË OKB-SË.....	26
BLLOKIMI I MAQEDONISË PËR ANËTARËSIM NË NATO.....	28
GJYKATA E HAGËS.....	28
ZGJIDHJA E KONTESTIT TË EMRIT	29
PËRMBAJTJA E MARRËVESHJES SË PRESPËS.....	30
-III- AKTIVITETET RRETH ANTARSIMIT NE ORGANIZATAT NDËRKOMBËTARE (BE/NATO).....	31
-HARMONIZIMI I LEGJISLACIONIT.....	32
POLITIKA E JASHTME.....	33
-II- KRITERET QË DUHET TI PLOTËSOJË MAQEDONIA E VERIUT SI VEND ANTAR I ORGANIZATAVE NDËRKOMBËTARE.....	33
-REPUBLIKA E MAQEDONISË DUHET T’I PËRMBUSH KRITERET POLITIKE.....	35
MAQEDONIA E VERIUT KA RATIFIKUAR TË GJITHA DOKUMENTET QË LIDHEN ME ORGANET KONVENCIONALE (NË TABELË).....	40
KUSHTET TË CILAT BE-JA IA PARASHTRON RM-SË PËR ANËTARËSIM KOMISIONI EUROPIAN.....	42
EFEKTET E DEFINIMIT TË OBJEKTIVAVE TË VITIT PËR ANËTARËSIM NË BE	47
ANTARSIMI NË BE DHE NATO SI GARANCË PËR STABILITETIN E SHTETIT.....	49
PËRFITIMET E MAQEDONIS SË VERIUT NGA ANTARSIMI NË NATO...53	53
-IV- MAQEDONIA E VERIUT SI INTERES GJEOPOLITIK I ORGANIZATAVE NDËRKOMBETARE.....	54
MAQEDONIA NË FOKUSIN E EUROPËS.....	55
INTERESAT E KINËS NË MAQEDONINË E VERIUT DHE NË BALLKANIT PERËNDIMOR.....	56

RAPORTI PROGRESIV I MAQEDONISË NGA KOMISIONI EUROPIAN.....	57
SISTEMI GJYQËSOR I MAQEDONISË SË VERIUT.....	60
LUFTA KUNDËR KORRUPSIONIT.....	60
MEDIAT.....	60
BASHKËPUNIMI RAJONAL.....	61
KRITERET EKONOMIK.....	61
ZGJEDHJET	62
PARLAMENTI.....	62
SHOQËRIA CIVILE.....	62
PËRFUNDIMI.....	63
BIBLIOGRAFIA.....	64

1. Lënda e hulumtimit (Arsyetimi i Propozim -Tezës së magjistraturës)

Duke parë që marrëdhëniet ndërkombëtare janë kyçe për një shtet e në rastin e studimit tim për shtetin e Maqedonisë, une jam fokusuar që ta shtjelloj këtë fushë dhe të thellohem më shumë në politikën e jashtme me fokus të veçantë pas pavarësimit.

Gjatë këtij punimi fillimisht do të fokusohem tek teoritë që ekzistojnë për politikën e jashtme përkatësisht kur dhe si është zhvilluar më herët dhe fazat se si është zhvilluar gjatë kohës e deri në ditët e sotme dhe kjo na nevojitet për të vendos një bazë të këtij punimi dhe vazhdimin e tij më tutje.

Punimi do të jetë i organizuar dhe i ndarë në katër kapituj dhe me mjaftë kujdes në secilin kapitull kemi trajtur nëntema që lidhen me tezën e paraqitur.

2. Qëllimët e hulumtimit

Qëllimi kryesor i këtij punimi është që të tregojmë se si Maqedonia si shtet i dal nga ish-Jugosllavia dhe që fitoi pavarësinë në vitin 1991, ka zhvilluar për më shumë se 26 vite politikën e saj të jashtme në sistemin ndërkombëtar.

Përmes këtij punimi kam për qëllim që të analizoj veprimet në politikat e jashtme të shtetit të Rm-së, prioritetet, mekanizmat, institucionet dhe nivelin e suksesit në arritjen e objektivave strategjike të shtetit, në politikat e jashtme.

Uroj, që ky punim në të ardhmen të jetë burim dhe nxitje për hulumtime të tilla të ngjashme nga kolegët e mi dhe kjo ti shërbej shoqërisë, po pse jo dhe shtetit të Maqedonisë.

3. Arsyeshmëria e punimit të tezës

Arsyet janë:

- 1) Politike e jashtme është fushë jo shumë e studiuar në Maqedoni
- 2) Meqënëse mungon një qasje kritike në literaturën shkencore lidhur me efikasitetin e politikave të jashtme në vend, konsideroj se është e nevojshme të jap një vlerësim të pavarur rreth asaj se sa kanë qënë të sukseshme politikat e jashtme të Rm-së.
- 3) Mungon një analizë shkencore e implementimit të strategjive qeveritare për anëtarësim në organizatat ndërkombëtare, por edhe zgjidhjes së problemeve të hapura me fqinjët, në kuadër të kësaj do të konstatojë nëse mungojnë apo jo rezultatet e parashikuara.

4. Hipotezat

Duke parë pra që politika e jashtme e Maqedonisë ka kaluar një çerek dekadë, normalisht që ajo duhet njohur që nga fillet e saj, për arsye të fitimit të njohurive të para bazë, por shumë të rëndësishme për të vazhduar më tutje rreth anëtarësimit në BE dhe NATO.

Hipoteza kryesore

Maqedonia nuk e ka krijuar infrastrukturen e duhur diplomatike dhe vullnetin politik, për realizimin e objektivave në politiken e jashtme.

Hipotezat ndihmese

Subjektet politike në RM të cilat përbejnë pushtetin u mungon guximi që të zgjedhin çështjet e hapura me vendet fqinje për shkak të impaktit politik në vend.

Maqedonia vonohet në zgjidhjen e problemeve të cilat kanë impakt në anëtarësimin e vendit në organizatat ndërkombëtare.

5. Metodologjia e hulumtimit

Hulumtimi do të realizohet me aplikimin e metodave të ndryshme të studimit në mënyrë që të arrihet një rezultat sa më i qartë dhe preciz.

Me rastin e hulumtimit është përdorur metoda deskriptive-historike, metoda krahasuese, e analizës dhe metoda empirike (intervista).

Metoda historike-deskriptive

Përmes kësaj metode do të shqyrtoj aspektin historik të zhvillimit të politikavë të jashtme të Maqedonisë që nga pavarësimi i saj dhe njohja në organizatat ndërkombëtare si OKB, Këshilli i Evropës, OSBE dhe nisma tjera rajonale.

Përveç kësaj do të analizoj literaturën e deritanishme që lidhet me përshkrimin e politikave të jashtme si dhe do të shqyrtoj dokumentacionin relevant si: ligje, strategji dhe planet nacionale dhe deklaratat e zyrtarëve.

Metoda krahasuese

Përmes kësaj metode do të bëj krahasimin në qasjen e politikave tek subjektet e ndryshme politike të cilat nga pozita e pushtetit veprojnë dhe kanë ndikim mbi politikat e jashtme të shtetit.

Metoda e analizës

Do të analizoj nëse politikat e jashtme mbrenda periudhes kohore të përcaktuara për këtë studim, kanë qënë apo jo në drejtimin e duhur për të arritur objektivat e përcaktuara në dokumentet zyrtare.

Metoda empirike -Interviste

Në kuadër të këtij punimi rëndësi të vecantë përmes një kapitulli i përkushtohet intervistës me autoritete të shtetit dhe zyrtarëve puna e të cilëve drejtë për drejtë lidhet me politikat e jashtme të shtetit, duke filluar nga ministra aktuale dhe të mëparshem për punë të jashtme .

Do të intervistojë edhe autoritet shkencore fusha e veprimit e të cilëve lidhet me politikat e jashtme.

HYRJE

Me shpërbërjen e ish Republikës Sovjetike Federale Jugosllave RSFJ u mundësua edhe krijimi i shteteve të pavarura, si pjesë e ish RSFJ-së pavarësinë e saj e mori edhe Republika e Maqedonisë.

Me 8 shtator viti 1991 u mbajt referendumi ku shtetasit të Rm-së 95% votuan pro pavarësimin dhe sovranitetin shteteror.

Nëpërmjet rrugëve të paqes Maqedonia erdhi deri te krijimi i shtetit.

Që nga vet krijimi i shtetit të Republikës së Maqedonisë 8 shtator 1991, u krijuan edhe marrëdhëniet jo të mira diplomatike me fqinjët,shkak kjo mos pranimit të emrit të shtetit nga ana e shtetit grek.

Sot e kësaj dite Maqedonia është në luftë diplomatike për zgjidhjen e emrit të shtetit, zgjidhje kjo e cila prej vitit 1991 është ende në procesin e saj.

Që nga vet krijimi i shtetit Maqedonia po kalon nëpër etapa të ndryshme politike-diplomatike, është shtet në tranzicion politik që nga shpallja e pavarësisë.

Në qendër të punimit do të kem rrjedhojen historike të Maqedonisë se si vijon zhvillimi në marrëdhëniët ndërkombëtare.

Në vitin 1993 Maqedonia u bë anëtare e plotë e Organizatës së Kombeve të Bashkuara, pasi veç më pala greke haptas tregon mospajtimin e saj për njohjen si shtet me emrin Maqedoni vëndoj veto që në Okb të pranohet me referencën e përkohshme si: “Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë”, (deri sa të gjendet zgjidhje mes dy shteteve të përfshira në kontest) pra Maqedonia

numëron 25 vite të plota si anëtare e Organizatës së Kombeve të bashkuara. Poashtu Maqedonia është shtet kandidat për në Bashkimin Evropian dhe njëkohësisht anëtare e plotë e Këshillit të OKB-së dhe Evropës.

Politikat e Maqedonisë janë serioze për anëtarësimin në strukturat euro-atlantike BE-ja dhe NATO gjithmonë kanë qënë pika kyçe e çdo subjekti politik në Republikën e Maqedonisë. Mund të shohim në çdo fushatë të çdo subjekti politik qoftë ato të bllokut maqedonas ose shqiptar në programet e tyre pikë kryesore kanë pasur dhe kanë, anëtarësimin e RM-së në strukturat euro-atlantike.

Shtrohet pyetja se çfarë e shtyn Maqedoninë që me çdo kusht të jetë në NATO dhe BE? Pikë së pari për sigurinë dhe vendosjen e themeleve njëhere e mirë si shtet demokratik, shtet që garanton siguri për çdo individ që jeton dhe vepron në këtë shtet pa dallim përkatësisë etnike, shtet që do të ketë stabilitet ekonomik, fuqi punëtore të mos emigrojnë jashtë vendit por të jenë pjesë e progresit të shtetit.

Dukshëm vërehet rënia e popullsisë në vend, kjo si pasojë e migrimit në vendet e Bashkimit Europian, barometër për uljen e popullsisë është edhe numri i votuesve që sa vjen e pakësohet, barometër tjetër është edhe mbyllja e shume shkollave kryesisht në fshatra, në qytet mbyllen klasa për arsye mos regjistrimi i nxënësve nëpër shkolla, mungesa e bluzave të bardha sa vjen e shtohet e pasojat e këtij migrimi kryesisht do i kenë gjeneratat që vinë pas.

Këto janë arsyet e forta që çojnë qeverinë me çdo kusht të jetë pjesë e BE dhe Nato. E cila qeveri po përmbush me shpejtësi kërkesat e ndërkombëtareve nisur nga zhbllokimi i negociatave me vendin fqinj grek, pa harruar këtu marrëveshjen me Bullgarinë, për miqësi dhe fqinjësi të mire, marrëveshja e Përzhinos, ligji për avancimin e gjuhëve, pra të gjitha “detyrat e shtëpisë” deri

në këto momente Maqedonia po i kryen me sukses,gjitha këto janë garancion se Maqedonia përballon me sukses të gjitha instruksionet nga ndërkombëtarët.

Në kapitullin e parë do të përfshijë zhvillimin historik të politikave të jashtme të Republikës së Maqedonisë pas pavarësimit të saj, poashtu anëtarësimin në OKB (organizata e kombeve te bashkuara), anëtarësimin në Këshillin e Evropës 1995,participimi në OSBE dhe participimi i Maqedonisë në nismat rajonale.

Për sa i përket kapitullit të dytë,aty do përfshihen raportet fqinjësore - diplomatike me:

Shqipërine,Kosovën,Bullgarinë,Sërbi dhe shtetin grek.

Pjesë të rëndësishme në kapitulline e tretë zënë aktivitetet reth anëtarësimit në Organizatat Ndërkombëtare (BE,NATO),në bazë të cilave kriteret duhet të plotësohen qe Maqedonia të jete pjesë e tyre.

Analizë rreth Maqedonisë si interes gjeopolitik në politikat ndërkombëtare,dhe faktor për sigurinë e rajonit.

Sa i përket kapitullit të katërt do kem në fokus: **Poltikat e jashtme dhe të mbrendshme si faktor ndikimi në poltikat e jashtme dhe anasjelltas**, duke përfshire metoden empirike me ekspertë të lëmisë së diplomacisë dhe për fund analizë raportit progresiv të Maqedonisë nga komisioni European.

Në pjesën përmbyllëse do jetë një analizë dhe nje konkluzion i përmbledhur nga të gjitha faktet dhe të dhënat të cilat janë të lidhura ngushtë me diplomacinë e shtetit të Rm-së.

KAPITULLI I

1. Zhvillimi Historik I Politikave Të Jashtme të Maqedonisë Pas Pavarësimit

Zhvillimi i Maqedonisë si shtet i pavarur dhe demokratik natyrisht që nuk ishte i lehtë, Maqedonia zgjodhi rrugën paqësore të largohet nga influenca serbe duke treguar se Maqedonia është për vend demokratik me synime drejt rrugëve të Bashkimit Europian dhe Nato.

Kjo lëvizje ishte një sukses për politikën dhe lidhësit e Maqedonisë në atë kohë.

Menjëherë mbas referendimit i cili u mbajt me 8 shtator viti 1991 Maqedonia nisi hapat e parë drejt pavarësimit të saj si një shtet i pavarur dhe demokratik. Me dëshirën e madhe të popullit, udhëheqsat shtetërorë u zotuan për aktivizimin e gjithë resurseve diplomatike shtetërore për arritjen e parë në historikun e politikës së jashtme të Maqedonisë, për tu njohur si shtet sovran dhe i pavarur.

Me 19 dhjetor 1991 parlamenti maqedonas miratoi deklaratën e njohjes së Republikës së Maqedonisë si shtet i pavarur dhe demokratik.

Mirëpo nuk mjaftonte vetëm krijimi i shtetit për të arritur stabilitetin, Maqedonia medoemos duhetjtë jetë anëtare e organizatës së kombëve të bashkuara. Gjë e cila i garantonte shtetin stabilitetin dhe sigurinë e vendit duke mos lënë rrugë për trazira dhe përcarje.

Si metodë për arritjen e qëllimit kyç, udhëheqësia nisi me dërgimin e letrave (formë kjo gjysëm zyrtare), nëpër ambasada të vendeve të ndryshme dhe nëpërmjet tyre kërkonte njohjen e pavarësisë së shtetit duke u bazuar në vullnetin e lirë të njerëzve të shprehur në referendum.¹

Të tilla letra u dërguan nga presidenti Gligorov dhe ministri i punëve të jashtme Denko Maleski.

Kërkesa për njohjen e Republikës së Maqedonisë si shtet i pavarur dhe demokratik të

menjëhershme dhe pozitive i kishte përgjigjet vetëm nga disa shtete si: Bullgaria,

Sllovenia, Kroacia, Turqia dhe Filipinet.

Pra e para që e njohu RM-në ishte Bullgaria e menjëherë pas saj Sllovenia, Kroacia dhe nëse analizojme njohjet e para janë njohje logjike do thoja që dikur kanë qënë një (përveç Bullgarisë).

Por Mbeshtetjen dhe përkrahjen më të madhe Maqedonia e ndjeu me njohjen nga shteti turk, shtet i cili njihet për rëndësinë që ka në arenën ndërkombëtare. Njohja e largët nga Filipinet, erdhi si rezultat i relatave të mira që kishin me ish Republikën Federale Jugosllave.

Vetëm një nga 4 fqinjët kishte pranuar pavarësinë e RM-së, pritej që Shqipëria të njihnte sovranitetin e Maqedonisë edhe pse pak më vështirësi (gjë e cila nuk ndodhi), por nuk pritej nga Serbia dhe Greqia duke ditur interesat e tyre.

¹ Gligorov.2001.p.271

Anëtaresimi në OKB

Organizata e Kombeve të Bashkuara është themeluar pas Luftës së Dytë Botërore me qëllim përforcimin e bashkëpunimit midis shteteve në botë.

Me iniciativën e shteteve fituese të Luftës së Dytë Botërore ,kjo organizatë ishte si vazhdimësi e Lidhjes së Kombeve e cila u formua në vitin 1919 por nuk kishte suksesin e pritur fakt edhe dështimi për të parandaluar luftën e dytë botërore.

Kjo nismë nisi të procedohej në vitin 1945 në San Francisko,ku u mbajt mbledhja themeluese e OKB-së. Ideja për formimin e OKB-së që të themelohej një organ i përhershëm si

Këshilli i Sigurimit i cili do të kujdesej për ruajtjen e paqes në botë dhe stabilitetin përmes zhvillimit ekonomik,social.

Fillimisht ishin vetëm katër aneëtarë të përhershëm : Britania e Madhe,BRSS,SHBA dhe Taiëani deri në vitët e 70-ta,ku vendin e saj më pas e zë Kina.Që nga ajo kohe e deri më sot këto 5 shtete janë anëtare të përhershme të Keshillit të Sigurimit me të drejtën absolute të vetos, ndërsa 10 shtete kohë pas kohe zgjidhen si anëtare jo të përhershme dhe pa të drejtën e vetos.OKB është organizatë ndërkombëtare ku si parim dhe për qëllim ka sigurinë ndërkombëtare ,zhvillimin ekonomik dhe barazi sociale.

Në fillim ishin të anëtarsuara vetëm shtetet fituese dhe ato neutrale gjatë Luftës së Dytë Botërore por më pas u anëtrësuan edhe shtete tjera siç ishte Gjermanija dhe Japonia dhe tjerat me radhë. Në vitet 1950 dhe 1960 nisi fluksi më i madh i anëtarësimeve në OKB kohë kur kolonitë e vjetra u çliruan dhe formuan shtete të pavarura.

Qendra e Organizatës së Kombeve të Bashkuara ndodhet në Gjenevë, aktivitetet e saj i zhvillon në qendrën e selisë në Nju Jork, ShBA ku sekretar i përgjithshëm aktual është Antonio Guterres.

Sot OKB numëron gjithsej 193 shtete anëtare si organizatë e shteteve të pavarura dhe sovrane.

Burimi juridik i OKB-së është Karta e OKB-së dhe Statusi i Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë në Hagë.²

Si funksionon Organizata e Kombeve të Bashkuara:

² Reka.Blerim.2013:

OKB-ja u themelua nga 26 shtete anëtarë të cilat e kishin aprovuar Kartën e Atlantikut dhe kishin nënshkruar dhe Deklaratën e Kombeve të Bashkuara ku kjo deklaratë përcaktonte parime të kësaj organizate si : paqe, siguri, pavarësi dhe të drejtat e njeriut.

Në nenin 1 mbron shtetin sovran por njëkohësisht mbron të drejtat dhe liritë e njeriut. Do të thotë që kjo organizatë ndërkombëtare vepron si organizatë ndërqeveritare ku përfaqësohen vetëm shtetet sovraane dhe qeveritë sovraane të pavarura dhe si e tillë funksionon mbi bazën dhe vullnetin politik të shteteve anëtare.

Struktura e sistemit të Okb përbëhet nga :

- * Asambleja e përgjithshme e OKB-së në Nju Jork.
- * Këshilli i Sigurimit të Okb-së, Gjenevë.
- * Këshilli i mirëbesimit i OKB-së.
- * Sekretariati i OKB-së
- * Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë, Hagë.

Ky vullnet shtetëror sovran i anëtarëve të OKB-së reflektohet në dy rrafshë.

Në rrafshin e asamblesë të përgjithshme, institucioni plenar i OKB-së i përfaqësuar nga secili shtet anëtarë, ku vlen sistemi i vendimarrjesh një shtet një votë apo shumica e votuesve, përkatësisht votimi nga 2/3 e shumicës ku ato më pak të rëndësishme kalojnë në sistemin 50%+1 ku çdo anëtarë ka të drejtën e një vote. Çdo vendim që merret nga ky organ quhet rezolutë.

Ndërsa sa i përket në rrafshin e Këshillit të Sigurimit institucion vendimarrës kryesor i OKB-së i përbërë nga 15 shtete anëtare ku pesë prej të cilave anëtare të përhershme me të drejtën e vetos, ndërsa 10 të tjerë jo të përhershëm ku zgjidhen me rotacion nga Asambleja çdo dy vite.

Pra për dallim nga Asambleja e Përgjithshme në Këshillin e Sigurimit votimi është konsensual.

OKB për qëllim ka ruajtjen e paqes dhe sigurisë botërore. Ky qëllim themelor do të zërthehej më tutje në aktin themelues dhe me Kartën e OKB në më shumë parime, prej të cilave kyçe mbeten:

- 4) Ruajtja e paqes dhe Sigurisë Ndërkombëtare.
- 5) Të drejtat e njeriut.
- 6) Inaugurimi i bashkëpunimit ndërkombëtarë.
- 7) Inaugurimi i fqinjësisë së mirë.
- 8) Zgjidhje paqësore të konflikteve.
- 9) Mospërzierjen në punët e mbredshme.
- 10) Ruajtja dhe garantimi i integritetit territorial të shteteve anëtare.
- 11) E drejta për vetvendosje të kombeve.

Roli i Këshillit të Sigurimit është një ndër organet më të rëndësishme që ka për detyrë mirëmbajtjen dhe sigurinë mes kombeve. Vendimet të cilat i merr ky organ quhen rezoluta dhe janë të obligueshme. Takimin të parë në histori Këshilli i Sigurimit e ka pasur në janar të vitit 1946.

Këshilli i Sigurimit ka të drejtën e përdorjes së forcës në konflikte të armatosura por me kusht që të gjitha shtetet anëtare të jenë dakord.

Gykata Ndërkombëtare e së Drejtës me seli në Hagë është organ gjyqësor i OKB-së e cila merret me zbatimin e të drejtës ndërkombëtare.

Përbëhet nga 15 gjyqtarë të cilët zgjidhen nga Asamblejamsi organ juridik OKB ka për detyrë të vedosë për probleme të ndjeshme.

Sekretariati i përgjithsëm i OKB-së nuk është organ vendimarrës është më tepër si përfaqësues administrativ i OKB-së i cili raporton para këtij organi. Ku përveç se mbledh të mbledh fakte dhe të dhëna për situatën ekonomike në botë njëllohisht shkruan raporte dhe informon për veprimtarinë e OKB-së.

Kushtet për anëtarësim në OKB:

a) kushtet materiale

1. të jesh shtet sovran dhe i pavarur

2. të jesh shtet paqedashës

3. të pranosh obligimet që dalin nga Karta dhe Statuti i OKB-së

4. të zotohesh që do ti përmbushësh obligimet të cilat dalin nga këto dokumente bazike të OKB-së dhe

5. të dorëzosh aplikimin tek Sekretari i Përgjithshëm i OKB-së.

b) kushti formal i të qenit anëtar është i përcaktuar në nenin 4 pika 2 të Kartës së OKB-së ku shprehimisht përcaktohet së për të qënë anëtar fillimisht duhet që Asambleja e Përgjithshme të votojë më së paku më 2/3 e votavedhe ky votim më vonë të miratohet nga 9 votat e këshilit të sigurimit ku pesë prej të cilave duhet të jenë anëtarë të përhershëm.³

Këshili Ekonomik dhe Social kujdeset për mirëqënien ekonomike sociale, gjendjen sociale, kulturore, humanitare për të gjitha komunitetet në mbarë botën. Ku veprimtaria e tij në vendet më pak të zhvilluara zhvillohet përmes organeve të specializuara të OKB-së siç janë:

* UNDP- programi për zhvillimin e kombeve të bashkuara

* UNHCR- komisioni i lartë i kombeve të bashkuara për refugjatët

³ Reka Blerim.2013

* UNICEF- fondacioni ndërkombëtar i fëmijëve më nevoja

* UNESCO- Organizata e Kombeve të Bashkuara për Arsim, Shkencë dhe Kulturë.

Anëtarësimi i Maqedonisë në OKB pranohet me datë 8 prill të vitit 1993 me rezolutën e Asamblesë të Përgjithshme, me rekomandim të Këshillit për Siguri e mbajtur me rezolutën 817 të Këshillit të sigurisë më 7 prill 1993. Për shkak të mos pranimit të emrit kushtetues Republika e Maqedonisë në mënyrë absolute nga pala greke anëtarësimi i Maqedonisë në OKB pranohet me referencën Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë. Dy vendet i filluan bisedimet nëpërmjet ndërmjetësimeve nga Kombet e Bashkuara me qëllim zgjidhjen e problemit dhe anashkalimin e problemeve mes dy vendeve anëtare.

Athina më të drejtën e vetos bllokoi hyrjen e Maqedonisë në Nato si dhe njëkohësisht fillimin e bisedimeve me Bashkimin Evropian.

Sot Republika e Maqedonisë numëron gjithsej 170 shtete me të cilat ka pasur bashkëpunim dhe marrëdhënie diplomatike ndërsa sa i përket njohjes së emrit të saj kushtetues është njohur nga 130 shtete ku 3 nga këto janë anëtare të përhershme të Këshillit të Sigurimit, Rusia, Kina, SHBA.

Duke pasur parasysh pozitat që pala greke kishte njëkohësisht dhe lobin brenda unionit ndërkombëtar kundrejt palës maqedonase e cila nuk kishte as suportin dhe pozitën për arritjen e qëllimëve në rrafshin ndërkombëtar në vazhdimësi bllokonte çdo mundësi që të bllokonte hyrjen e Maqedonisë në NATO dhe BE.

Edhe pse me gjithë këto pengesa Maqedonia rriti të zë një ulësë në Organizatën e Kombeve të Bashkuara ku parimi një shtet një votë i jep të drejtë Maqedonisë të realizojë interesat kombëtare.

Maqedonia me kërkesë të saj ishte pritese e misionit të parë parandalues i cili mision për qëllim kishte parandalimin e dhe përhapjen e aktiviteteve ushtarake nga ish republikat jugosllave.

OKB në maqedoni shtrin aktivitet e saj nëpërmjet organizatav të cilat kanë për qëllim ruajtjen e paqes stabilitetin ekonomik ,respektimin dhe liritë e të drejtave të njeriut, mbrojtjen e minoriteteve dhe një sër aktivitetesth të tjera.

Disa nga Organizatat ndërkombëtare në Republikën e Maqedonisë janë: OSBE,UNICEF,UNHCR,UNDP,UNESCO,OBSH,OSCE.

Me datat 24 dhe 25 korrik të vitit 2012 si pjesë të vizitës në rajonin e Ballkanit ,Sekretari i Përgjithshëm Ban Ki-Moon kishte vizitën e tij të parë në Maqedoni.

E rëndësishme është zgjedhja e Dr.Srgjan Kerim si kryetar i Asamblesë së 62-të të përgjithshme.

Maqedonia në OKB është e pozicionuar si një vend me orientim të qartë evropian i vendosur për mbrojtjen e të drejtave të njeriut,duke respektuar parimet qe dalin nga Karta e OKB-së ,Maqedonia është një shtet që mbështet multilateralizmin si një instrument i cili promovon paqen dhe mbron të drejtat e njeriut dhe zhvillimin ekonomik.

Anëtarësimi në Këshillin e Evropës

Këshilli i Evropës është organizata më e vjetër e Evropës e cila numëron 47 vende anëtare 27 prej tyre janë shtete anëtarë të Bashkimit Evropian.,selia e KE është në Strasburg-Francë ku gjuhë zyrtare është gjuha angleze dhe gjuha frënge

Gjykata Evropiane për liritë dhe të drejtat e njeriut paraqet organin më të rëndësishëm të themeluar në vitin 1959.

Të gjitha shtetet anëtare nënshkruajnë Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut,dokument ky i cili hartohet për të mbrojtur të drejtat e njeriut-demokracinë dhe shtetin e së drejtës.

Struktura organizative e Këshillit të Evropës përbëhet nga:

Dy organet ligjore të KE-së janë Komiteti i ministrave i përbërë nga ministrat e jashtëm të çdo vendi anëtar dhe Asambleja Parlamentare e përbërë nga anëtarë të çdo shteti anëtar.

Komiteti i Ministrave- është organ vendimarrës i cili përbëhet nga ministrat e punëve të jashtme të shteteve anëtare ose nga përfaqësuesit e përhershëm diplomatik në Strasburg.

Komiteti i Ministrave përcakton politikën e Organizatës ku njëkohësisht miraton buxhetin e saj si dhe përcakton programin e veprimtarisë.

Asambleja Parlamentare- organ vendimarrës ku ndryshe edhe njihet si motorri i Këshillit të Evropës.Nga kjo Asamble kanë dalur traktate të shumta ndërkombëtare ,të cilat kontributine tyre e japin për të krijuar një legjislativë ndërkombëtare.

Përfaqësuesit e Asmblesë Parlamentare emërohen nga parlamentet kombëtare të çdo shteti anëtar.

Sekretar-i/ja i/e përgjithshme -zgjidhet çdo dy 5 vjet nga Asambleja Parlamentare në krye të organizatës. Obligim ka planifikimin strategjik ,orientimin dhe zbatimin e programeve të aktiviteteve, buxhetin dhe drejtimin e organizatës.

Sekretari i Përgjithshëm njëkohësisht udhëheq sekretariatit e organizatës morgane të tjera të mëdha Të KE-së përfshijnë Drejtorinë Evropiane për Cilësinë e barnave dhe Observatorin Evropian Audioviziv.

Zv: Sekretar-i/ja i/e përgjithshëm- poashtu zgjidhet nga Asambleja çdo 5 vjet me anë të një votimi ndryshe nga ai i Sekretarit/res të përgjithshëm.

Kongresi i Autoriteteve Lokale dhe Rajonale- ky institucion i Këshillit është përgjegjës për forcimin e demokracisë lokale dhe rajonale mes 47 vendeve anëtare.

Përbëhet nga dy dhoma:

Dhoma e Autoriteteve Lokala dhe dhoma e rajoneve, përbëhet nga tre komisione, ku së bashku me 648 anëtarë të zgjedhur përfaqëson mbi 200.000 autoritete lokale dhe rajonale.

Gjykata Evropiane e të drejtave të njeriut- Kjo gjykatë është organ gjyqësor i përhershëm i cili garanton të gjithë evropianëve të drejtat e parashikuara në Konventën për të drejtat e njeriut.

Në gjykatën Evropiane mund të drektohen shtetet ose individët pa maëë parasysh kombësinë e tyre.

Të gjitha vendet anëtare të Këshillit të Evropës janë palë në Konventë.

Komisioni për të drejtat e njeriut- është organ i pavarur ,përgjegjës për të promovuar edukimin dhe sensibilizimin për të drejtat e njeriut dhe respektimin e tyre në vedet anëtare. Ky komison ka rolin themelor parandalues .

Konferenca e OJQ-ve

Përbëhet nga 400 organizata joqeveritare ,konferenca krijon lidhjen midis përfaqësuesve politik dhe qytetarëve.Sjell zërine shoqërisë civile në Këshillin e Evropës.

Maqedonia në Këshillin e Evropës

Me datë 9 nëntor 1995 Republika e Maqedonisë u bë anëtare me të drejta të plota në Këshillin e Evropës,Vend anëtar i 38-i me radhë në organizatë.

Maqedonia prioritet ka përforcimin e mbrojtjes të drejtave të njeriut,progresin e integritetit,promovimin e pjesmarrjes së të rinjve.

Republika e Maqedonisë kryeson në Komitetin e ministrave në Këshillin e Evropës nga muaj maj deri në nëntor të vitit 2010,kryesimi me komunitetin e ministrave ishte mundësi që të legjitimohet si përfaqësues i parimeve dhe vlerave mbi të cilat fillon organizata ku gradualisht të sigurohet edhe vazhdimësia e aktiviteteve të plota të KE-së.

Maqedonia merr pjesë në mënyrë aktive ,plotëson të gjitha obligimet të cilat dalin nga dialogu post-monitoring,duke përmbushur kështu të gjitha detyrimet dhe kërkesat që vinë në kuvendin e parlamentit të KE-së,siç janë rekomandime nga:

Komisioni Venecian,Karta sociale Evropiane, Konventa për mbrojtje të pakicave,Konventa për parandalimin e torturës, Komisioni Evropian kundër racizmit dhe jo tolerancës etj.

Për ta bërë sa më të lehte mbarëvajtjen e procesit të zbatimit të programit të përbashkët me Bashkimin Evropian ”Ndërtimi i kapaciteteve të agjencive të zbatimit të ligjit për trajtimin e duhur të të paraburgosurve dhe të dënuarve” me propozim të Këshillit të Evropës u hap një zyrë

në vitin 2012 me seli në Shkup. Në prill të vitit 2016 me iniciativë të Këshillit Evropian dhe BE-së u propozua një program për ndihmë të vendeve anëtare të Ballkanit Përqendror dhe Turqisë u aprovua një ndihmë për një periudhë tre vjeçare dhe me shumën totale të buxhetit prej 25 milionë euro, Për Maqedoninë projekti është në fazën e implementimit ku 3.9 milion euro janë siguruar si nevojë e përdorimit të mjeteve në fushat kryesore: në sigurimin e gjyqësorit, luftën kundër korrupsionit, luftën kundër krimit ekonomik dhe krimit të organizuar dhe mbrojtjen e të drejtave të grupeve të cilave ju cënohet ë drejta dhe liritë.

Projekti “Mbrojtja e të Drejtave të dënuarve” nisi në qershor të vitit 2016 dhe projekti “Respektim i të drejtave të njeriut në polici” nisi në shtator të vitit 2016.

Në vitin 2019 gjithsej numërohen gjashtë projekte të mbështetura me horizontal facility, të cilat janë në proces zbatimi.

Faza e dytë e të ashtëquajturës horizontal facility 2019-2021 do të përfshijë Ballkanin Përqendror dhe Turqinë u prezentua me 9 tetor 2019 në Shkup, iniciativë e cila është për bashkpunim midis BE-së dhe KE-së për Ballkanin Përqendror dhe Turqinë. Pjesa e dytë e programit do të përfshijë me aktivitete edhe vendet e rajonit si Shqipëri, Kosovë, Bosnje dhe Hercegovinë, Mali i Zi, Serbi, Turqi.

Mekanizmi i cili ofron ekspertizë legislative dhe njëkohësisht këshilla të politikave brenda sistemit të Këshillit të Evropës mbetet pjesë e rëndësishme e programit për të gjithë përfituesit. Fondi i programit është me shumën prej 41 milion euro ku 85% është e financuar nga BE dhe 15% nga KE.

Temat të cilat do të përfshihen janë:

* sigurimi i drejtësisë

* luftimi i krimit ekonomik

* luftimin e diskriminit dhe mbrojtjen e te drejtave të grueve të cënuara

* liria e shprehjes dhe liria e mediave

Participimi në OSBE

Organizata më e madhe rajonale në botë për siguri, stabilitet, ruajtjen e pqaes në botë numëron 57 shtete pjesmarrëse, ku përfshin vende si : Amerika e Veriut, Evropë dhe Azi.

OSBE- organizata për siguri dhe bashkëpunim në Evropë u themelua në vitin 1975 me seli në Vienë, themelohet më Aktin e Helsinkit gjithsej me 36 shtete pjesmarrëse ndërsa në Konferencën e Budapestit ne vitin 1995 riorganizohet një organizat ndërkombëtare me 56 shtete pjesmarrëse nga Evropa, Azia e Mesme, gjithashu edhe nga Amerika Veriore.

Kjo organizatë strategji ka bazën e në praktikat demokratike ku për qëllim ka mbrojtjen ,sigurinë, stabilitetin politik dhe zhvillimin ekonomik.

Kryetare aktual e OSBE-së është ministre e punëve të jashtme e Mbretërisë së Suedisë, Ann Linde.

Anëtarësimi i Maqedonisë në OSBE- organizata për siguri dhe stabilitet

Kërkesën për anëtarësim në Organizatë, Republika e Maqedonisë e paraqiti në vitin 1992, kjo kërkesë nuk u pranua për shkak të kundërshtimeve ngashteti grek dhe Shqipëria ku kjo e fundit më vonë ndryshoi qëndrim. Republika e Maqedonisë fitoi statusin e vëzhguesit në vitin

1993. Maqedonia si vend anëtarë luan një rol aktiv në organizatë, mori përsipër kryesimin e Komitetit për çështje ekonomike dhe poashtu mbrojtje e mjedisit në vitin 2007.

Në vitin 2012 zgjidhet shef i i zyrës së OSBE-së në Turkmenistan diplomati maqedonas si dhe emërimi i një përfaqësuesi maqedonas për udhëheqës vëzhgues të OSBE-së për vëzhgimin e zgjedhjeve (2009) në Kargistan dhe Armeni.

Maqedonia i takon grupit të vendeve të cilat janë në zhvillim përmes ndihmave dhe përvojës nga kjo organizatë ku më vonë me shpresë se kjo përvojë do të ndikojë në stabilitet.

Në vitin shtator -dhjetor të vitit 2012 Republika e Maqedonisë kryeson me forumin për Bashkpunim të Sigurisë së OSBE-së ku prioritetet e saja ishin:

* Promovimi i kontributit në rajonin e Evropës Juglindore e cila ka të bëjë me krijimin e stabilitetit dhe implementimin e masave për të krijuar besim dhe sigurimnjëllohësisht gjetja e zgjidhjes për konfliktet e ngrira, zbatimimi i vendimeve të marra në lidhje me armët e vogla dhe të lehta, zbatimin e rezolutave 1540 dhe 1325 të Këshillit të Sigurimit të OKB-së.

Misioni i OSBE-së në Maqedoni ka filluar me punë në shtator të vitit 1992, misioni i cili është edhe misioni më i vjetër në vendin tonë, ku për qëllim kishte parandalimin e ndonjë konflikti të mundshëm në rajon.

Aktivitetet e misionit zhvillohen në harmoni konstante me autoritetet maqedonase.

Misioni i OSBE-së në Maqedoni gjithashtu ka për qëllim të ndihmojë institucionet në vend për përmirësim të mëtejshëm të legjislacionit të shtetit më atë të BE-së ,me reformat të cilat lidhen më procesin e vendit në Bashkimin Evropian.

Participimi i Maqedonisë në nismat rajonale

Me shpërbërjen e ISH RSFJS-së Maqedonia në vazhdimësi ishte vend vend që rrezikonte destabilitetin dhe sigurinë kështu që organizatat ndërkombëtare kishin synim sigurinë dhe paqën e vendit fillimisht me vendet e rajonit dhe ato më gjërë.

Por në të njejtën periudhë kohore edhe vendet fqinje ishin në tranzicion dhe përballëshin me sfida të brendshme dhe probleme të profileve të ndryshme.

Pas shpërbërjes të saj Maqedonia dhe vendet e rajonit kishin vështirësi në definimin e dhe rënditjen e prioriteteve të sigurisë së vendit si pasojë e qëndrimeve të ashpra nacionaliste të autoriteteve vendore dhe mungesa e komunikimit të ndërsjellë.⁴

Me kalimin nga komunizëm në demokraci dale ngadale largohet edhe frika nga agresioni dhe fillimi i ndonjë konflikti me vendet fqinje.

Me ndarjen nga Jugosllavia u bënë 5 shtete të rajonit të cilat ndryshuan komplet gjeopolitikën e rajonit të Ballkanit dhe ndryshoi qasjen e SHBA-ve dhe BE-së kundrejt tyre.

Maqedonia gjithmonë ka qënë dhe vazhdon të jetë e hapur për çdo lloj bashkpunimi rajonal mes vendeve fqinje dhe më gjërë me qëllim zhvillimin dhe stabilitetin rajonal.

Përkrah bashkpunimit në iniciativat rajonale Maqedonia në vazhdimësi është pjesë e proceseve si në zhvillimin infrastrukturor, në zhvillimin e energjetikës dhe telekomunikacionit nuk harron edhe nismat të cilat i përkasin zhvillimit të vendeve rurale njëkohësisht edhe ripërtitjen e vendkalimeve kufitare dhe hapjen e vendkalimeve të reja me vendet fqinje.

⁴ Pendarovski Stevo.2009.p.203.

Maqedonia dhe vendet e rajonit vënduan themele të forta duke pasur parasysh dëshirën e tyre për integrimin në strukturat euro-atlantike fillimisht filluan me vënien e normave dhe standardeve euro-atlantike të sigurisë, përparimin legjislativ ku pikë kyçe e RM-së është krijimi i stabilitetit në vend, bahkpunim rajonal dhe global me qëllim krijimin e kushteve të një vendi të denjë në Bashkimin Evropian.

RAPORTI MAQEDONI SHQIPËRI

Me shpalljen e pavarësisë së Maqedonisë filloi dhe ndërtimi i marrëdhënieve dy palëshe me vendet fqinje të rajonit.

Nëse kthehemi pas historikisht Shqipëria përherë ka pasur rezerva sa i përket qëndrimit të saj në raport me shtetin maqedonas, e cila me të drejtë kërkonte që të plotësoheshin kërkesat dhe të drejtat e shqiptarëve në Maqedoni.

Me ardhjen e ministrit të jashtëm shqiptar në janar të vitit 1992 Ilir Boçka i cili kushtëzoi se njohja e shtetit maqedonas do të bëhëj nëse plotësohej përmbushja e kërkesave të pakicës shqiptare në Maqedoni.⁵ Kjo gjë ngjalli pakënaqësi nga opinioni i palës maqedonase ku sipas tyre pakica shqiptare gëzonte të drejtat e tyre mbështetur në mendimin e dhënë nga Komisioni i Badenterit. Ato e morën si kërcënim kërkesën e qeverisë shqiptare duke e fajësuar vendin fqinj se ndërhyr në politikat e mbrendshme të vendit gjë që sipas tyre mund të krijonte lindjen e një konfliktit të mundshëm brenda mes etniteteve.

⁵ Gligorov.2001.f.396

Nuk ishte në favor të asnjë pale lindja e një konflikti fqinjësor e as një konflikti brenda për brenda shtetit mes pakicës shqiptare dhe nacionalitetit maqedonas.

Në qershor të 1992 Presidenti i Republikës së Maqedonisë vizitoi Tiranës zyrtare, Viktor Gaber ishte shefi i parë konsullor i RM-së në Tiranë ndërsa përfaqësues i parë i Shqipërisë në Maqedoni ishte Leonid Mertiri.

SHBA-të ishin të koncentruara në ndërtimin e stabilitetit dhe sigurisë për të dy vendeve.

Republika e Shqipërisë kishte trysni të vazhdueshme nga SHBA-të që të mos ndërhynte në konfliktet mbrenda shtetit, e sidomos presion i vazhdueshëm për mos ndërhyrje gjatë trazirave për Univerzitetin e Tetovës(4 qershor 1994).

E gjitha kjo përpjekje nga ana e SHBA-ve kishte për qëllim ruatjen e stabilitetit dhe paqes në Ballkan.

Njohja e Republikës së Maqedonisë nga ana e Republikës së Shqipërisë ndodhi me 26 prill të vitit 1993 ku qeveria shqiptare doli me një deklaratë të veçantë ku dha njohje zyrtare të Republikës së Maqedonisë me referencën Ish RSFJ kjo për qëllim mos prishjen e raporteve me shtetin grek dhe nga ana tjetër duke lënë të hapur çështjen e shqiptarëve në Maqedoni e cila duhet të zgjidhej bashkë me çështjen e Kosovës.

Pas njohjes së Maqedonisë në OKB, për Maqedoninë filloi një epokë e re ,e cilla zhvillohej gradualisht por njëkohësisht edhe me probleme nga sfera të ndryshme.

Pas shpërbërjes të Ish RSFJ-së si Maqedonia dhe Shqipëria ishin vende në tranzicion nga komunizmi, në vështirësitë e tyre për demokracinë e vendit, si nga aspekti politik por edhe kalimi i sfidave ekonomike nga ekonomi e planifikuar në ekonomi tregu.⁶

Qëllimet e të dyja vendeve fqinje ishin të qarta ,të anëtarësojnë vendin e tyre në NATO dhe BE kjo gjë do tu siguronte ruajtjen e stabilitetit, sigurinë e vendit dhe ekonomi të fuqishme.

Në Shqipëri epoka e tranzicionit kaloi me shumë trazira në vend, me thyerje monumentesh historike të Enver Hoxhës, trazira të shumta të cilat çuan në prishjen e aparatit shtetëror.

Të dyjat vende fqinje nisën të marrin nisma për procesin e anëtarësimit në NATO dhe BE. Ndërmorrën nisma të ndryshme në kuadrin e “Gripit të Adriatikut” ku dy vendet fqinje nisin të mbartnin procese të rëndësishme në ndihmë të refugjatëve nga konflikti në Kosovë dhe ndërhyrjen e NATO-s.

Në kohën kur shteti grek kishte vendosur bllokadë për Maqedoninë Shqipëria hapi kufijtë dhe portet e saj të cilat mundësuan furnizimin e Maqedonisë.

Kjo lëvizje ishte një hap shumë i rëndësishëm për relatat diplomatike mes shteteve , e veçanërisht me rëndësi të madhe për ekonominë e RM-së.

Gjatë trazirave që po përcillnin Shqipërinë Maqedonia i ndihmoi Republikës së Shqipërisë me hapjen e aeroportit të Ohrit.

Në nivel tjetër e çoi marrëdhënien diplomatike mes vendeve fqinje edhe njohja e pakicës maqedonas në Shqipëri, ku ky veprim u cilësua si shenjë veprimi i miqësisë së mirë mes vendeve fqinje por edhe u mor si shembull për Ballkanin.

Në anën tjetër ne shqiptarët e Maqedonisë filluan përfaqësimin në institucionet më të larta shtetërore ku përmes partive politike morën pjesë në të gjithë qeveritë e koalicionit.

Pas Marrveshjes së Ohrit dhe me ndryshimet kushtetuese, shqiptarët në Maqedonisë fituan përfaqësim dhe trajtmi më ndryshe ndërsa gjuha shqipe si gjuhë e dytë zyrtare sepse përfshinte 20% të komunitetit shqiptar në vend.

Raporti Kosovë - Maqedoni

Njohja e Republikës së Kosovës (17.shkurt 2008) si shtet sovran dhe i pavarur nga Republika e Maqedonisë erdhi si rezultat i faktorit shqiptar që përfaqësonte pozitën e shqiptarëve në qeverinë e Maqedonisë.

Për të ardhur deri te pavarësia e Republikës së Kosovës u deshën shumë vite mund,sakrificë dhe sfida me të cilat u përballën vendasit e Republikës së Kosovës nga ana e regjimit serb nën ushëheqjen e okupatorit Millosheviq.

Kjo liri erdhi nga Ushtria Çlirimtare e Kosovës UÇK flijimi i shumë dëshmorëve që ranë për lirinë e vendit që pasardhësit e tyre të frymonin lirshëm në Kosovën e tyre të lirë dhe të pavarur. Me ndërhyrjen e SHBA-ve dhe NATO-s në Kosovë okupatorit serb ju dha grushti i fundit. Mbështetja nga Ushtria e Shqipërisë dhe nga NATO dha vulën e fitores për Kosovën heroike.

Maqedonia gjatë kohës së luftës kur vendasit lëshonin shtëpitë e tyre dhe kufiri më i afërt ishte me Maqedoninë dhe Shqipërinë ,kapaciteti i Maqedonisë ishte deri te pritja e 20.000

refugjatëve ndërsa shifra reale arriti deri diku 350.000. refugjatë kjo solli ndryshime demografikë në Maqedoni.

Sigurisht që ky fluks menaxhohej me shumë përkushtim dhe vullnet të mirë nga shqiptarët në Maqedoni si ato në qeveri por edhe popullata shqiptare sytë i kishte të kthyer nga Kosova.

Me 11 qershor viti 1999 u nënshkruajt Marrveshja e Kumanovës,ku siguronte shqiptarët e dëbuar mund të kthehshin të lirë dhe të sigurt në shtëpitë e tyre në Kosovë.

Pas vët pavarësimit të shtetit, kryeministri Ljubco Georgievski vizitoi Prishtinën ku prej atje tregoi synimet për hapjen e zyrave të misionit maqedonas në Kosovë dhe anasjelltas ,këto lëvizje nuk u pritën mirë në opinionin maqedonas duke pasur parasysh edhe ndikimin serb që ende gjente qasje për të ndërhyr në politikat e vendit.

Në një anë lobi i përfaqesuesve shqiptar në qeveri në kontinuitet iniconte mbarëvajtjen e procesit të njohes së shtetit të Republikës së Kosovës dhe me datën 9 tetor të vitit 2008 Maqedonia e njohu Kosovën si shtet sovran dhe të pavarur,por me kushtin e vetëm që shënimi i kufirit prej 158 km me Kosovën do të respektohej sipas planit të Ahtisarit.⁷

Nuk vonoi shumë që pas njohjes së Kosovës ,Maqedonia hapi ambasadën e saj në Prishtine dhe anasjelltas.

Vendet gëzojnë fqinjësi të mirë duke përmbushur detyrimet e tyre që ju jepen nga faktori ndërkombëtar për krijimin e një rajoni të sigurtë dhe klimë të mirë ekonomike.

në vazhdimësi të dyja vendet janë pjesmarrëse të shumë ndihmave që ju ofrohen nga organizatat ndërkombëtare për avansim dhe zhvillim të shoqërisë që të mund të inkuadrohen në proceset euro-atlantike.

Bashkëpunimi Ekonomik

Kosova është një ndër partnerët më të rëndësishëm në treg ku deportimi i mallrave zhvillohet lirshëm dhe pa dogana gjë e cila është në interes të Maqedonisë .

Ky bashkëpunim ekonomik zhvillohet me CEFTA marrëveshjen dhe marrëveshjen për bashkëpunim ekonomik mes dy vendeve fqinje.

Bashkëpunimi mes dy vendeve në mbrojtje dhe siguri,u kalimi kufitar mes dy vendeve mund të bëhet edhe me letërnjoftim pa pasur nevojë për pasaportë me qëllim lehtësimin e levizjeve të qytetarëve të të dyjave vende.

Me datë 09 janar viti 2020 arrihet bashkpunim reciprok mes dy vendeve për njohjen e lejeve për qarkullim.Në kontinuitet po thellohet bashkpunimi mes dy vendeve fqinjë si në kulture.shëndetësi,transport,përmirësimin e ambientit jetësor dhe me arritjen e marrëveshjes mes dy palëve për Malin Sharr për ta deklaruar Park Nacional.

KONFLIKTI I GJUHËS DHE TË DREJTËS TRASHËGIMORE HISTORIKE BULLGARI- MAQEDONI

Me vet krijimin e shtetit të Maqedonisë u krijuan edhe problemet të cilat edhe sot janë të pranishme në relatat Maqedoni - Bullgari të gjitha këto zhvillime erdhën si vazhdimësi politikës së Ish RSFJ-së e cila do të linte një hapësirë të madhe në rregullimin e marrëdhënieve diplomatike mes dy vendeve fqinje.

Situata sa vinte e komplikohet mes vendeve fqinje ,pas vizitës së kryeministrit bullgar në vitin 1990 i cili erdhi për të negociuar për marrëveshje ekonomike mes dy vendeve fqinje,megjithëse kjo marrëveshje nuk u nënshkrua në Asamblenë Nacionale Bullgare.Arsyeja e kësaj u bë e ditur më ardhjen e ministrit të arsimit Marko Todorov në Shkup kur ai refuzoi të nënshkruajë deklaratën për bashkëpunim në arsim dhe kulturë mes dy vendeve fqinje ,më arsyen se kjo marrëveshje ishte e shkruar në gjuhë bullgare dhe se gjuha maqedone është dialekt bullgarë e jo gjuhë e veçantë.Ky moment ishte moment ku relatat mes dy vendeve stagnuan.

Me 15 janar të vitit 1992 Bullgaria ishte e para që e njohu pavarësinë Republikës së Maqedonisë por nga ana tjetër nuk pranonte identitetin e një nacionaliteti maqedonas,mohonte gjuhën maqedonase duke thënë se është dialekt i gjuhës bullgare dhe jo gjuhë e veçantë, gjithashtu mohonte ekzistencën e një minoriteti të popullit maqedonas në Bullgari.Ky qendrim strategjik i Bullgarisë linte shumë hapësira dhe çështje për të diskutuar në vazhdimësi.

Në nivel ambasadash Maqedonia dhe Bullgaria relatat diplomatike i nisën në dhjetor viti 1993.

Presidenti Gligorov njohjen nga Bullgaria e shihte si shumë dyshuese dhe me qëllime të fshehta ndërsa kryeministri Ljupco Georgievski e shihte të rëndësishëm aktin e njohjes së Maqedonisë si shtet.

Sipas Presidentit Gligorov Georgievski është shprehur së: “për sa i përket kombeësisë maqedonase lërin historianët të flasin”.⁸

Nga ana tjetër ishin të arsyeshme veprimet nga pala bullgare duke pasur parasysh ëndrrën e tyre të shumë viteve përpara për Bullgarinë e Madhe ,mendimet e të cilës nuk mund të zhdukeshin brenda natës.

Me nënshkrimin e deklaratës për miqësi dhe bashkpunim mes dy vendeve fqinje do të fillontë edhe rregullimi i raporteve mes dy vendeve.

Deklarata e përbashkët u nënshkruajt me 22 shkurt 1999 në Sofje të Bullgarisë mes autoriteteve maqedonase dhe atyre bullgare,kjo deklaratë u nënshkruajt në të dy gjuhët zyrtare të shteteve fqinje dhe përmbajtja e tekstit të deklaratës në të dyja gjuhët ka rendësinë e njejtë. Ky formulim i të dyja gjuhëve pasoi edhe marrëveshjet tjera mes Bullgarisë dhe Maqedonisë.Pra shteti bullgar me nënshkrimin e deklratës njohu edhe realitetin e ekzistencës së Kushtetutës së RM-së e cila thotë se gjuhë zyrtare në RM është maqedonishtja pavarësisht se a e pranon ekzistencën e gjuhës.

Kjo marrëveshje kishte për qëllim bashkëpunimin përmirësimin e raporteve mes dy vendeve bashkëpunim për procesin në Bashkimin Evropian, mundësimin për të përmirësuar kushtet ekonomike, bashkëpunim në arsim,kulture,sport,turizëm duke mos lënë anash përmirësimin e lidhjeve infrastrukturore në bashkëpunim me vendet e rajonit.

Deklarata e përbashkët mes dy vendeve përfshin 4 pika kyçe të marrëveshjes :

* Të dy vendet nuk do të lejojnë që hapësira territoriale e shtetit të përdorët për të sulmuar shtetin tjetër.

⁸ Dejan Marolov.f.72.

* Asnjëra nga palët nuk do të ndërmarr veprime apo nxis konflikte të karakterit armiqësor me njëra tjetrën.

* Asnjë nga vendet fqinje nuk do të ketë pretendime territoriale ndaj njëra tjetrës.

* Republika e Maqedonisë në kushtetutën e saj deklaron se asgjë nuk mund dhe nuk do të interpretohen se ndonjëherë do të jenë bazë për ndërhyrjen e Maqedonisë në punët e mbrendshme të shtetit bullgar, me qëllim që të mbrojt statusin dhe të drejtat e personave të cilët nuk janë shtetas të RM-së.

Dy vendet zyrtare nuk është se ishin të kënaqura sa u përket relatave me njëra tjetrën, duke i përcjelle mesazhe njëra tjetrës ku nga njëra anë Maqedonia shprehte pakënaqësinë e saj ndaj Bullgarisë e cila nuk lonte regjistrimin e një partie maqedonase ku e njejtja ja rikujtonte në vazhdimësi njohjen e saj dhe duke ja bërë me dije se kjo njohje u bë me qëllim rregullimin e raporteve mes dy vendeve fqinje dhe jo zhvillimin e politikave jugo-maqedonase.

është shumë e rëndësishme të potencohet ndihma që ju dha shtetit maqedonas nga Bullgaria dhe Shqipëria të cilat ishin hyrja dhe dalja e vetme në jug të Detit Egjeshkaku embargos nga shteti grek.

Përveç bashkëpunimit ekonomik , dy vendet kishin edhe bashkëpunim ushtarak gjatë vitit 1999 ,i cili bashkëpunim arriti me nënshkrimin e një marrëveshje të bashkëpunimit në mbrojtje.

Për tu vlerësuar është edhe mbështetja që Bullgaria po i jep Maqedonisë në procesin e integritimit në strukturat euro-atlantike.

Por e gjitha kjo fqinjësi e mirë po merr një kthesë tjetër duke u bazuar në zhvillimet e fundit, kur gjithçka dukej që po hecete drejtë rrugës së duhur për anëtarësimin e Maqedonisë në Bashkimin Evropian ,qeveria bullgare në gusht të 2020 përpiloi një dokument prej 6 faqeve të

cilin ua dërgoi 26 kryeqyteteve të Bashkimit Evropian ku ju kërkon të ndalojnë me negociatat si dhe mos të pranojnë kombin dhe gjuhën maqedonase.

Ditëve të fundit në karnevalet e mbajtura në qytetin e Vevcanit u dogji flamuri bullgar dhe ky akt u cilësua si akt vandalizmi nga ambasadori bullgar i cili dërgoi një notë të ashpër verbale Ministrisë së Punëve të Jashtme të RMV-së. Të njëjtin reagim kishte dhe ministrja e Jashtme bullgare Ekaterina Zaharieva e cila me tone të ashpra dënoi djegjen e flamurit.

I menjëhershëm ishte reagimi i qeverisë së RMV-së nga ana presidentit Pendarovski i cili e dënoi djegjen e flamurit dhe shtoi:

“Djegia e flamurit të Republikës së Bullgarisë gjatë karnevalit është e paparanueshme dhe për tu dënuar. Mes fqinjëve është e nevojshme të ndërtohet respekti, besimi dhe mirëkuptimi”

Nuk mungoj edhe reagimi nga ana e ministrit të Jashtëm Bujar Osmani i cili tha se :

“Tradita shekullore nuk guxon të rrezikohet përmes aktiviteteve që nënçmojnë ose fyejnë popuj, shtete, në veçanti fqinjët tanë. E dënojmë djegjen e flamurit të Republikës së Bullgarisë në Karnevalin e Vevcanit akt që jo vetëm se e prish renomenë e Karnevalit por dëmton edhe imazhin e RMV-së”.

Sa i përket bllokadës nga shteti fqinj zyrtarët e RMV-së shprehen optimist se do të ndryshojë diçka në bisedimet pas fushatës zgjedhore në Bullgari, duke supozuar se kjo retorikë nga Republika e Bullgarisë vjen si rezultat i fushatës parazgjedhore atje.

Konflikti mbi identitetin maqedonas nga shteti grek

Që nga krijimi i Republikës së Maqedonisë si shtet i pavarur dhe sovran shteti grek kundërshtoi krijimin e shtetit maqedonas me emrin kushtetues Republika e Maqedonisë.

Me arsyen se Maqedonia po e shtrembëronte realitetin historik, Athina zyrtare u shpreh se ky vend fqinj adoptoi një emër i cili shpreh ambicie territoriale ndaj krahinës veriore të Maqedonisë. Kjo mosmarrëveshje ideologjike nisi që nga momenti i kërkesës nga Republika e Maqedonisë që të njihej me emrin e saj kushtetues si Republika e Maqedonisë ku reagimi i diplomacisë greke ishte i menjëhershëm duke kërkuar nga Organiza e Kombeve të Bashkuara që nëse bëhëj njohja e shtetit duhej ndryshim në kushtetutën e Republikës së Maqedonisë, ndryshime në flamurin për të cilin grekët shprehen se ishte dielli i Verginës i cili njihej si simbol i Maqedonisë Antike dhe sigurisht ndryshimin e emrit. Këto kërkesa ishin të papranueshme për RM-në dhe si rezultat i kësaj Greqia në vazhdimësi “kërcënonte” me bllokimin për anëtarësim të Maqedonisë me të drejtën e vetos. Në periudhën e vitit 1992 Fondi Monetar, Konferenca Ndërkombëtare dhe Banka Botërore pranuan Maqedonisë nën referencën IRJM.

Që tju jepej fundi mosmarrëveshje mes dy palëve Maqedonia miratoi amandamentin I dhe II me 6 janar viti 1992, nëpërmjet të cilit u bë ndryshimi dhe plotësimi i amandamentit 3 dhe 49 në kushtetutë ku deklaronte se nuk ka pretendime territoriale dhe ndryshimi i flamurit, këto ndryshime u bënë më kushtin që pala greke të mos kundërshtojë anëtarësimin e Maqedonisë në OKB.

Anëtarësimi në OKB

Në vitin 1993 me presion të ndërkombëtarëve e sidomos nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës gjindet zgjidhje e përkohshme me vendin fqinj që Maqedonia të njihet si shtet i pavarur dhe sovran me referencën Ish Republika Federale e Jugosllavisë Maqedonase mirëpo në

ndërkohë të nisë procesi i menjëhershëm i negociatave për zgjidhjen e problemit bashkë me ndërmjetësues ndërkombëtrë.

Përmes rezolutes 817 Këshilli i Sigurimit miratoi vendim pranimin e Maqedonisë në OKB, në rezolutë u theksuan disa pika kyçe të marrëveshjes:

- * Referenca IRJM do të përdorej deri sa të zgjidhet kontesti mes dy vendeve fqinje.
- * IRJM është veç një referencë dhe jo emër.
- * Referenca IRJM mund të përdorej vetëm në OKB ndërsa sa ju përket organizatave të tjera nuk ishin të detyruara, Këshili i Sigurimit kërkoi që Maqedonia dhe Athina me ndihmën e ndërmjetësuesit të Sekretarit të Përgjithshëm në OKB të nisin bisedimet rreth emrit.

U zhvilluan shume diskutime për zgjidhjen e mundshme të problemit me një sërë propozimesh si :Maqedonia e Re, Sllavo-Maqedonia, Maqedonia e Epërme apo Maqedonia-Shkupi, të gjitha këto ishin të papranueshme si nga Shkupi por edhe nga Athina e cila i kundërshtonte të gjitha propozimet të cilat mbanin emrin Maqedoni, propozimet që vinin nga pala greke ishin si : Republika e Vardarit ose Republika e Shkupit por që të dyja këto kundërshtuan nga Shkupi zyrtar.

Nga ana tjetër Greqia dhe Maqedonia përkundër kundërshtimeve politike në fushën e ekonomisë kishin bashkëpunim shumë të suksesshëm, Greqia u bë investitori më i madh në Maqedoni.

Me 16 shkurt 1994 Greqia mbylli portin detar në Selanik, pikat kufitare, hekurudhat si dhe mbylljen e konsullatës së përgjithshme në Shkup. Kjo ishte një grusht i fuqishëm për ekonominë e vendit por gjithashtu një krizë politike në vend.

Zëvendës ministri i jashtëm Xhorxh Papandreu u shpreh se kjo embargo vjen si leksion “për të mbushur mend Shkupin”.

Duke u arsyëtuar për jo fqinjësi të mirë dhe jo zhvillimi të raportit mes dy vendeve pala greke mbështeste politikën e saj dhe veprimtarinë diplomatike me argumentet për ndryshimin e emrit kushtetues si dhe çështjet historike. Nga ana tjetër ndërmjetësuesit ishin në vazhdimësi për gjetjen e një marrëveshjeje mes dy vendeve ,dy muaj më vonë Komisioni Evropian kërkon që të verifikohet embargoja greke si shkelje e të Drejtës së Unionit Evropian.

E gjitha kjo gjeti zgjidhje të përkohshme me 13 shtator të vitit 1995 në Nju Jork me nënshkrimin e një marrëveshje të përkohshme midis Republikës së Greqisë dhe Ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë, në marrëveshje u kërkuar nga pala greke që:

*Republika e Maqedonisë të sigurojë më preambullën e kushtetutës gjithashtu neni 3 dhe 49 të qartësojë se nuk ka pretendime territoriale

*të ndryshojë diellin me 16 krahë në flamur

Ndërsa kërkesat nga IRJM ishin që Greqia mos të bllokonte anëtarësimin e Maqedonisë në Organizata Ndërkombëtare.

Menjëherë pas kësaj filluan edhe marrëdhëniet e para mes shteteve ndërsa sa i përkiste çështjes për emrin u la që të negociohet me mbikqyrjen e Organizatës së Kombeve të Bashkuara.

Në janar të vitit 1996 në Shkup u hap zyra e parë për lidhje me shtetin grek ku shef i saj i parë ishte Aleksandros Maljas.

Ndërsa një vit më vonë kah mesi i muajit shkurt viti 1997 Athina zyrtare hap zyrën e saj për lidhje me IRMJ-në ku shef i parë u emërua Lupço Arsovski.

Në Nju Jork me datë 13 tetot viti 1995 u nënshkrua Memorandumi për masat praktike , për të realizuar Marrëveshjen e Perkohshme kjo gjë mundësoi që po në të njëjtin vit të

nënshkruhen marrëveshjet për regjim reciprok të vizave dhe njëkohësisht taksave mes dy vendeve fqinje si për komunikacion poashtu edhe transport, në dogana duke përfshirë këtu edhe kartonin e gjelbër ndërkombëtarë për sigurim të veturave.

Ndërmjetësuesi Metju Nimic i cili për më shumë se 20 vite ndërmjetësonte mes dy vendeve për të gjetur zgjidhjen e emrit dhe çështjet historike të lëna hapur dhe pa zgjidhje.

Blokimi i Maqedonisë për Anëtarësim në NATO

Në prag të Samitit të NATO-s në Bukuresht kur gjithçka pothuajse po hecete në rrugë të duhur për pranimin e Republikës së Maqedonisë në NATO edhe përkundër njohjes nga më shumë se 120 shtete me emrin e saj kushtetues përfshirë këtu edhe njohjen zyrtare nga SHBA në vitin 2004, Athina zyrtare po përgatitej për të bllokuar çdo mundësi përderisa nuk kishte ndryshime për emrin duke potencuar në vazhdimësi se do të përdornin të drejtën e vetos nëse nuk do ishte gjetur zgjidhje për emrin.

Ndërmjetësuesit ndërkombëtarë ishin në përpjekje të vazhdueshme për zgjidhje duke u përfshirë përsëri në bisedime Niimitz gjithashtu u përfshi në bisedime edhe Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s Jaap De Hoop Schefer por Athina e bëri të qartë qëndrimin e saj në mars gjatë mbledhjes së ministrave të jashtëm se do të përdorte veton për anëtarësim të Maqedonisë.

Ndërkombëtarët po përpiqeshin që të gjejnë mënyrë për mos prishjen e Marrëveshjes së Përkohshme por njëkohësisht edhe mos bllokimin e Maqedonisë për në NATO, nga Washingtoni në Shkup erdh edhe ndihmës sekretari i përgjithshëm për Çështje Evropiane Daniel Fried i cili po përpiqej që të nxis Shkupin për kompromis.

Megjithë angazhimet dhe iniciativat Greqia qëndroi stoike në vendimin e saj dhe në Samitin e mbajtur në Bukuresht të Rumanisë, Greqia bllokoi anëtarësimin e Maqedonisë në NATO duke u bazuar në relatat jo të mira fqinjësore dhe mos zgjidhjen e çështjes së emrit.

Në arenën ndërkombëtare ishte dëshpëruese sjellja e Republikës së Greqisë duke e marrë parasysh se atë e shihnin si udhërrëfyese të Ballkanit në strukturat euro-atlantike.

Gjykata e Hagës

Maqedonia pakënaqësinë e saj e shprehu me ngritjen e padisë në Gjykatën e Hagës me 17 nëntor viti 2008 me pretekstin së pala greke ka shkelur nenin 11 të marrëveshjes ku aty parashihet se Maqedonia nuk do ta pengonte anëtarësimin e Maqedonisë në NATO dhe organizatat tjera ndërkombëtare si dhe mbajtjen peng të shtetit për anëtarësim në NATO.

Vendimi që u morr nga Gjykata e Hagës ishte se Republika e Greqisë ka bërë shkelje të marrëveshjes së përkohshme dhe se pret që pala greke mos të çënojë për së dyti herë të drejtën ndërkombëtare.

Ndërsa u refuzuan të gjitha akuzat nga pala greke se Maqedonia ka shkelur marrëveshjen e përkohshme .

Pra Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë vërtetoi se kundërshtimi i Greqisë është shkelje e së drejtës ndërkombëtare.

Faktori kryesor dhe i vetëm i cili bllokoi Maqedoninë ishte Greqia për anëtarësim në Nato, me arsyetimin e raporteve jo të mira fqinjësore dhe mos zgjidhjen e emrit. ku nga

ndërkombëtarët pritej qe herë tjetër mos bllokonte Maqedoninë si dhe mos të përsëriste shkeljen e së drejtës ndërkombëtare e cila do të ishte mos respektim i Gjykatës së Hagës.

Synimi i Rm-së në kontunitet ishte që sa më shpejtë Republika e Maqedonisë të ishte pjesë në strukturat euro-atlantike mirëpo nga ana tjetër nuk ishin të gatshëm për ndryshim të emrit duke marr parasysh edhe nacionalitetin që mbizotronte te popullata.

Zgjidhja e emrit Republika e Maqedonisë së Veriut

Pas 27 vitesh diksutime ,takime të shumta me ndërmjetësues nga jashtë për qëllim gjetjen e zgjidhjes së emrit dhe rregullimin e marrëdhënieve diplomatike mes dy vendeve gjë e cila ishte në favor të të dyja vendeve fqinje më në fund po gjente zgjidhje kontesti shumë vjeçar mes dy vendeve.

Maqedonia dhe Greqia nënshkruan marrëveshjen për zgjidhjen e kontestit shumë vjeçar për emrin,dokumenti qe parasheh emrin “Maqedonia e Veriut” .

Për dy vendet fqinje datë historike u bë data e 17 qershor të vitit 2018, në fshatin Psarades në anën Greke të Liqenit të Prespës u hap një kapitull i ri për të rregulluar marrëdhëniët midis dy shteteve me Marrëveshjen Finale për zgjidhjen e kontesteve të përshkruara në rezolutat 817 (1993) dhe 845 (1993) si dhe përfundimin e rëndësisë së Marrëveshjes së Përkohshme të vitit 1995 me qëllim për të krijuar partneritet strategjik midis dy palëve.

Kjo marrëveshje u nënshkrua nga Ministri i Punëve të Jashtme të Maqedonisë Nikolla Dimitrov dhe ministri i jashtëm grek Nikos Kotzias me prani të dy kryeministrave Zoran Zaev dhe Aleksis Tsipras.

Ku ky i fundit i shpreh shumë i lumtur me zgjidhjen e emrit duke e cilësuar se është shumë e rëndësishme për krijimin e raportit mes dy vendeve.

Aleksis Tsipras: “Kjo është një marrëveshje patriotike mes dy popujve ku me këtë zgjidhet kontesti shumëvjeçar,forcon besimin mes dy vendeve ku kjo marrëveshje do të hap edhe një faqë të re në zhvillimin ekonomik mes dy shteteve”.

Ndërsa kryeministri maqedonas zoran zaev u shpreh se: “Me nënshkrimin e kësaj marrëveshje po i japim fund një kontesti,dalimeve shumëvjeçare të cilat kihsin ngritur murë mes dy shteteve,kemi humbur shumë por pas shumë përpjekjeve arritëm për një marrëveshje të dinjitetshme për ndërtimin e miqësisë mes vendeve.Nga e kaluara duhet mësuar dhe jo të përsëerisim”.

Morën pjesë shumë përfaqësuese të lartë ndërkombëtarë si dhe ndërmjetësi i OKB-së Metju Nimic ,shefja e diplomacisë evropiane Federika Mogerini,komisioneri Johanes Hahn,Rozmari Di Karko,Antoni Guteresh si dhe diplomat nga shumë vende përfundimtare.

Përmbajtja e Marrëveshjes së Prespës

Marrëveshja e nënshkruar nga dy ministritë parashikonte:

- * Emri - Republika e Maqedonisë së Veriut me përkthim në të gjitha gjuhët ,për përdorim të përgjithshëm ,të specifikuar në ndryshimin e Kushtetutës
- * Gjuha- Maqedonase siç është pranuar në Konferencën e tretë të KB-së për standardizimin e emrave gjeografik e cila u mbajt në Athinë 1977 dhe siç është e përshkruar në nenin 7 paragrafi 3 dhe paragrafi 4 i kësaj marrëveshje.
- * Termet “Maqedonia” dhe “maqedonase” e kanë domethënien në nenin 7.

* Kodi i vendit në targa të regjistrimit të automjeteve do jete NM ose NMK, ndërsa për gjithë qëllimet tjera kodi do mbetet MK ose MKD (me ISO standardizim).

Menjëherë pas ratifikimit nga të dy vendet me 12 shkurt 2019 filloi me përdorimi i emrit të ri Republika e Maqedonisë Veriore.

Nënshkrimi i kësaj marrëveshje hapi perspektivë për RMV në strukturat euro atlantike dhe evropiane, Athina menjëherë dërgoi letra BE-s dhe NATO-s duke i informuar se do të mbështetste nismën e bisedimeve për anëtarësim të RMV-së me emrin dhe kushtet e rëna dakord në Marrëveshjen e Prespës

BIBLIOGRAFIA

1. A. Aliu: Proceset e Integritit euroatlantik dhe R.M., CRPA, Tetovë, 2008, fq. 131 9 Shih:
Raportin e Komisionit Europian për të arriturat e Maqedonisë për vitin 2006 PERSPEKTIVAT
EURO-ATLANTIKE TË RM-SË
2. A. Aliu: Proceset e Integritit euroatlantik dhe R.M., CRPA, Tetovë, 2008, fq. 131
3. A. Azizi: Shteti i së Drejtës dhe Reformat në Administratën Publike: Rasti i Maqedonisë,
përmbledhje tekstesh shkencore, UEJL, Tetovë, 2008, fq. 63 13 Shih: Komunikatën e NATO-s të
Samitit të Bukureshtit PERSPEKTIVAT EURO-ATLANTIKE TË RM-SË
4. A. Ibrahim: Institucionet politike të BE-së: Komisioni Europian, Logos-A, Shkup, 2003 11 J.
Shasivari: Proceset e Integritit euroatlantik dhe R.M., CRPA, Tetovë, 2008, fq. 197-214
PERSPEKTIVAT EURO-ATLANTIKE TË RM-SË
5. Andreë Heywood, “Politika”, Brezi ’81, Prishtinë, 2008.
6. Armstrong, D. Et al (2009) Organizatat Ndërkombëtare në Politikën Botërore, (Tiranë)
7. Austrian Development Agency, Referati për Maqedoninë, “Maqedoni plani 2007-
2009”, botuar nga Ministria Federale për Çështjet Europiane dhe Ndërkombëtare,
Vjenë
8. B. Reka & A. Ibrahim: Studime Europiane, UEJL, Tetovë, 2004 fq. 246-250
9. Bekim Baliqi, “Hyrje në diplomaci dhe politikë të jashtme”, 2010, Prishtinë.
10. Blerim Reka “Ligjerata të autorizuar nga lënda: Hyrje në të marrëdhënie
ndërkombëtare” (Shkup-Uejl 2013)
11. Blerim Reka, Bardhok Bashota, Ylber Sela, “Marrëdhëniet Ndërkombëtare” 2016.
12. Christopher Hill, “The changing politics of foreign policy”, 2003, Great Britain,
PALGRAVE.
13. David Armstrong et al., “Organizatat Ndërkombëtare në Politikën Botërore”, fq. 287 –
308
14. EUROPEAN COMMISSION Brussels, 6.10.2020, Raporti final për Maqedoninë e
Verut SWD(2020)

15. Exploring the Sources of Greek Foreign Policy Towards the Former Yugoslav Republic of Macedonia (research article)
16. G.R. Berridge, "Diplomacia, teoria dhe praktika", DUDAJ, 2010, Tiranë.
17. Glenn P. Hastedt, "Politika e jashtme amerikane – e shkuara, e sotmja, e ardhmja", 2010, Tiranë.
18. Hoel, B. Reka dhe Y.Sela (2010) Institucionet dhe Politikat e Unionit European (Tetovë:Universitates).
19. J. Shasivari: Proceset e Integritit euroatlantik dhe R.M., CRPA, Tetovë, 2008, fq. 197-214

PERSPEKTIVAT EURO-ATLANTIKE TË RM-SË
20. James D. Fearon, "Domestic politics, foreign policy, and theories of international relations", Annu Rev. Politi. Sci. 1998.
21. Joshua S. Goldstein, "Marrëdhëniet Ndërkombëtare", botimi i katërt, 2001, Tiranë.
22. Juliet Kaarbo, Jeffrey S. Lantis, Ryan K. Beasley, "The Analysis of Foreign Policy in Comparative Perspective", 2012.
23. Karl Dojç, "Analiza e Marrëdhënieve Ndërkombëtare", botimi i tretë, 1988, Tiranë.
24. Klaus-Diter Borçard, "ABC-ja e të Drejtës së Bashkimit European", 2010.
25. Mitjo Vaulasvirta, Representations of the "Balkans" in the Foreign Policy Discourses of Croatia , Macedonia and Bosnia Herzegovina ,2017.
26. Mr. B. Reka: E Drejta e Unionit European, KIEAI, Prishtinë, 2000, fq. 220-221 4 B. Reka & A. Ibrahim: Studime Europiane, UEJL, Tetovë, 2004 fq. 246-250 5, Marveshja për Asocim dhe Stabilizim, Maqedoni-UE PERSPEKTIVAT EURO-ATLANTIKE TË RM-SË
27. Nationalism and Small State Foreign Policy The Greek Response to the Macedonian Issue (published in political science quarterly,109 (4) 1994,647-668)
28. Paul Craig and Grainne De Burca, "EU Law: Text, Cases and Materials", faqe 3-54
29. Politickata Kultura, Evropeizacijata i Stravovite Vo Makedonija, (Izveshtaj od anketnoto istrazhuvanje "Evrometar" za 2014).
30. Ralph G. Feltham, "Diplomacia", 2010, Tiranë, AIIS.

31. Raportin e Komisionit European: COMMISSION OF THE EUROPEAN COMMUNITIES, Brussels, 08.11.2006, SEC (2006)1387, COMMISSION STAFF WORKING DOCUMENT The former Yugoslav Republic of Macedonia 2006 Progress Report.
32. Sër Harold Nikolson, "Diplomacia", Brezi '81, 2005, Prishtinë.
33. Steve Smith, Amelia Hadfield, Tim Dunne, "Politika e jashtme-teori, aktorë, raste", 2012, UET Press.
34. Theoretical and Legal Framework of Foreign Policy the Example of the Republic Macedonia- Official Eu Candidate Country, (research article: Dejan Marolov, José Noronha Rodrigues).
35. Upoznaj Evropsku uniju. (2007), Vodič kroz evropske integracije, Zagreb.
36. V. Latifi: Zhvillimi i negociatave I, IOSEMNI, 2007, fq. 95
37. V. Latifi: Zhvillimi i negociatave I, IOSEMNI, 2007, fq. 95 7 B. Reka & Y. Sela: Hyrje në të drejtën e UE-së, UEJL, Tetovë, 2007 fq. 45-46 PERSPEKTIVAT EURO-ATLANTIKE TË RM
38. Zejnullah Gruda, "E Drejta Ndërkombëtare Publike", Pjesa e Gjashtë: Organizatat Ndërkombëtare (Prishtinë, 2007)
39. Јован Маџовски, ЕТТ, 2009. PERSPEKTIVAT EURO-ATLANTIKE TË RM-SË

BURIME NGA INTERNETI

1. Minsitria e Punëve të Jashtme e Maqedonisë <http://www.mfa.gov.mk>
2. <https://www.consilium.europa.eu/media/43076/26-vc-euco-statement-en.pdf>
3. Komisioni European <http://www.consilium.europa.eu>
4. <http://www.mfa.gov.mk/default1.aspx?ItemID=263>
5. <http://ec.europa.eu/comm/enlargement/fyrom/index.htm>
1. http://www.bbc.com/news/special_reports
2. <https://www.reuters.com/resources/archive/us/20130905.html>

3. <http://www.un.org/documents/ga/res/47/a47r225.htm>
4. <https://www.sipri.org/yearbook/2004/files/SIPRIYB0408.pdf,%20p.%20271>
- 5.